

## Thirrje për propozime - Monitorimi i procesit të konsultimeve publike në nivel të qeverisë -

### Sfondi

Rregullorja 05/2016 mbi Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik (SMPK-ve)<sup>1</sup> është miratuar në prill të vitit 2016 dhe ka hyrë në fuqi më 1 janar të vitit 2017.

E propozuar nga KCSF-ja,<sup>2</sup> Rregullorja për SMPK-në e përcakton një listë shumë të hollësishme të obligimeve për të gjitha njësitë e qeverisë duhet t'i ndërmarrin gjatë hartimit të projekt-dokumenteve, në mënyrë që një proces i politikëbërjes të konsiderohet si i pranueshëm. Ajo në mënyrë të qartë i rendit të gjitha dokumentet që duhet t'u nënshtrohen konsultimeve publike; ia cakton përgjegjësinë për të zhvilluar konsultime publike zyrtarit përgjegjës për hartimin e propozimit specifik; i detajon detyrat specifike që duhet të ndërmerren për planifikimin dhe zhvillimin e procesit të konsultimit publik si dhe mbledhjen dhe trajtimin e komenteve të pranuar; e përcakton kohën dhe përmbajtjen e takimeve publike dhe konsultimeve me shkrim; e prezanton platformën online për konsultime publike, i përcakton funksionet e Koordinatorit të Konsultimit Publik në secilën ministri; e përkufizon Dokumentin Përfundimtar të Konsultimit si dokument të përfundimit të procesit të konsultimit publik; e obligon Qeverinë dhe njësitë e saj që të raportojnë rregullisht për hollësitë e këtij procesi; dhe shumë më shumë.

Nga prilli i vitit 2016 deri në janar të vitit 2017, qeverisë i është dashur që t'i kryente përgatitjet e nevojshme për zbatimin e kësaj rregulloreje, përfshirë platformën online për konsultime publike, emërimin e koordinatoreve të konsultimit publik, programet për ngritjen e kapaciteteve, metodologjinë e monitorimit dhe raportimit të brendshëm etj. Ndonëse me pak vonesë, nga tremujori i parë i vitit 2017, shumica e këtyre aktiviteteve janë përfunduar dhe rregullorja ka mundur të fillojë të zbatohet. Edhe pse një shkallë e zbatimit tashmë është e dukshme, megjithatë shumë procese të politikëbërjes ende nuk përputhen me standardet minimale.

Rregullorja për SMPK-në nuk është akti i parë normativ për këtë çështje. Përveç dispozitave kushtetuese të vitit 2008, një kornizë ligjore solide për konsultimet publike është krijuar që nga viti 2011, në të cilën bazohet edhe Rregullorja mbi SMPK-të. Siç nënkupton emri i rregullores, ky është vetëm minimumi të cilin duhet ta përmbushë qeveria, ndërsa nga kjo e fundit pritet të shkojë më tej gjatë zhvillimit të konsultimeve publike si në kuptim të metodave, ashtu edhe të fushëveprimit. Kjo vlen në veçanti për çështjet më komplekse ose dokumenteve më të rëndësishme të politikave apo legjislacionit.

Duke pasur parasysh faktin që qeveria e sponsorizon shumicën dërrmuese të dokumenteve të politikave dhe legjislacionit dhe duke e konsideruar procesin e konsultimit publik si hapësirë formale shumë të rëndësishme për kontributin e aktorëve jashtë qeverisë, monitorimi i zbatimit të procesit të konsultimit publik është me rëndësi të madhe për t'i kontribuar një politike më të mirë dhe për t'i bërë trysni qeverisë që gjatë politikëbërjes t'i shfrytëzojë të gjitha burimet e shoqërisë.

<sup>1</sup> Rregullorja 05/2016 mbi Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik ([http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Regullore\\_QRK\\_Nr.\\_052016\\_per\\_standardet\\_minimale\\_per\\_procesin\\_e\\_konsultimit\\_publick.pdf](http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Regullore_QRK_Nr._052016_per_standardet_minimale_per_procesin_e_konsultimit_publick.pdf))

<sup>2</sup> Zingjiri i Pakompletuar - Propozim i Politikave mbi Standardet Minimale për Procesin e Konsultimit Publik (KCSF). Janar 2015, Prishtinë. ([http://kcsfoundation.org/repository/docs/21\\_07\\_2015\\_4376832\\_KCSF\\_Incomplete\\_chain\\_english\\_final\\_2\\_.pdf](http://kcsfoundation.org/repository/docs/21_07_2015_4376832_KCSF_Incomplete_chain_english_final_2_.pdf))

Përkrahur nga:

## Metodologjia e monitorimit

KCSF-ja e ka zhvilluar një metodologji të hollësishme dhe të thukët të monitorimit<sup>3</sup> që i mbulon standardet kryesore që përcaktohen në Rregulloren mbi SMPK-të si dhe disa elemente të përzgjedhura që i tejkalojnë ato standarde dhe që janë thelbësore për një proces të duhur të konsultimit publik. Metodologjia synon ta vlerësojë nivelin e zbatimit të Rregullores mbi SMPK-të, duke i kontribuar ngritjes graduale të performancës së këtij procesi. Kjo mundëson edhe identifikimin e dështimeve, edhe promovimin e praktikave më të mira dhe tregimeve të suksesit.

Meqë vëllimi i planit vjetor të Qeverisë (përfshirë të gjitha ministritë dhe agjencitë e saj) në aspektin e politikave, dokumenteve strategjike dhe akteve normative është relativisht i lartë, monitorimi për vitin 2018 është planifikuar të përqendrohet vetëm në një numër të caktuar të ministrive dhe në dokumentet më të rëndësishme që i nxjerrin ato. Veç kësaj, metodologjia e lejon zgjerimin gradual dhe përfshirjen e mundshme të të gjitha dokumenteve që i nxjerr qeveria.

## Objektivat

Granti institucional i Sida-s është grant shumëvjeçar për Fondacionin Kosovar për Shoqëri Civile (KCSF-në), i financuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar (Sida), që synon ta mbështesë KCSF-në në zbatimin e misionit dhe strategjisë së saj. Që nga themelimi i saj, KCSF-ja ka qenë një aktor qendror në forcimin dhe financimin e sektorit të shoqërisë civile në Kosovë. KCSF-ja angazhohet në avancimin e ambientit të veprimit për shoqërinë civile në Kosovë dhe më gjerë, jep kontribut të drejtpërdrejtë në proceset e politikave dhe të ligjbërjes, i shtyn përpara mundësitë ligjore dhe praktike për pjesëmarrjen e shoqërisë civile në politikëbërje dhe Agjendën Europiane të Kosovës, ofron mbështetje për ngritjen e kapaciteteve të OSHC-ve dhe akterëve të tjerë dhe vepron si grantdhënës për donatorët kryesorë të shoqërisë civile që veprojnë në Kosovë. Puna e KCSF-së mbështetet në dy besime: 1) se një shoqëri civile e guximshme dhe efektive është e domosdoshme për avancimin dhe mbështetjen e tranzicionit demokratik të Kosovës dhe 2) se perspektiva e Integritit European është nxitësi më i fuqishëm i reformave të brendshme në Kosovë. Nëpërmjet fushës programore të saj të Zhvillimit të Shoqërisë Civile, KCSF-ja është e fokusuar në forcimin e shoqërisë civile në Kosovë dhe në shtimin e pjesëmarrjes së saj në procesin e politikëbërjes.

Përderisa një pjesë e rëndësishme e grantit të Sida-s shërben për t'i mbështetur aktivitetet që ndërmerren drejtpërsëdrejti nga programet e saj, KCSF-ja synon ta shtojë numrin e aktorëve të përfshirë dhe të mbështesë projekte specifike të OShC-ve të tjera për ta zbatuar strategjinë programore të saj. Në angazhimin e saj për ta mbështetur pjesëmarrjen e shoqërisë civile në proceset e politikëbërjes, KCSF-ja beson se, duke i mbështetur partnerët e shoqërisë civile, ajo do t'i kontribuojë drejtpërsëdrejti forcimit të rolit të sektorit civil dhe do ta shfrytëzojë potencialin e tij për t'u kontribuar politikave më cilësore në Kosovë.

Në mbështetjen e organizatave partnere për tu angazhuar në objektivat e KCSF-së, projektet në kuadër të kësaj Thirrjeje synojnë t'i angazhojnë organizatat e shoqërisë civile në monitorimin sistematik të konsultimit publik të proceseve të rëndësishme të politikave në kuadër të fushëveprimit të tyre, bazuar në metodologjinë e monitorimit të KCSF-së dhe në kriteret që janë shtjelluar më poshtë.

<sup>3</sup> Shih bashkëngjitur Dokumentin e shkurtë sqarues mbi Metodologjinë e monitorimit në vegzën e Thirrjes.

Përkrahur nga:

## Masat e mbështetura në kuadër të kësaj ndërrhyrjeje

Propozimet që duhet të dorëzohen si përgjigje ndaj kësaj Thirrjeje duhet të trajtojnë sa vijon:

- Monitorimin e konsultimeve publike për proceset e përzgjedhura të politikëbërjes<sup>4</sup> në nivel të qeverisë për periudhën 1 janar - 31 dhjetor 2018;
- Fokusimin në më së paku një dhe më së shumti dy njësi qeveritare (ministri apo Zyra të Kryeministrit);
- Fokusimin në jo më pak se tri procese të politikëbërjes për një njësi të qeverisë, për tu finalizuar pas publikimit të Planit Vjetor të Qeverisë për vitin 2018, duke u bazuar në një listë më të gjerë të proceseve të politikëbërjes që propozohet nga organizata aplikuese në fazën e aplikimit;
- Në listën e proceseve të politikëbërjes për monitorim duhet të jenë çështjet prioritare në agjendën e qeverisë, siç janë përkufizuar në dokumentet që janë renditur në tekstin e mëposhtëm (lista është përpiluar sipas prioritetit të dokumenteve të mëposhtme):
  - Agjenda e Reformave Europiane (ARE);
  - Programi Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA);
  - Shtjellimi i hollësishëm nga ana e aplikuesve lidhur me rëndësinë e proceseve specifike të politikëbërjes që nuk janë pjesë e dokumenteve të mësipërme;
- Njësitë qeveritare për tu monitoruar duhet ta mbulojnë fushëveprimin e njëjtë apo të ngjashëm me atë të organizatës aplikuese;
- Monitorimi duhet të bëhet në përputhje të plotë me metodologjinë e monitorimit të KCSF-së.

Nga organizatat aplikuese pritet që të demonstrojnë vijon:

- se janë të përkushtuara për ta trajnuar stafin e tyre, përmes KCSF-së, për procesin e konsultimit publik dhe metodologjinë e monitorimit të KCSF-së;
- se janë të përkushtuara për t'i raportuar KCSF-së rregullisht për rezultatet e procesit të monitorimit;
- se janë të përkushtuara për tu angazhuar në diskutime sistematike me KCSF-në dhe me organizatat e tjera të përzgjedhura për rishikimin e mundshëm të metodologjisë së monitorimit të KCSF-së, duke u bazuar në praktikën e monitorimit të vitit të parë.

Organizatrat që janë të përkushtuara për të marrë pjesë aktive gjatë konsultimeve publike formale dhe për të dhënë kontribut në proceset e politikëbërjes që do të monitorohen, përtej kontratës me KCSF-në, do të vlerësohen më lart gjatë procesit të vlerësimit.

## Kualifikueshmëria

KCSF-ja, përmes kësaj Thirrjeje, synon të kontraktojë shërbime nga OSHC-të që kanë kapacitete për ta monitoruar konsultimin publik të proceseve të përzgjedhura të politikave që u kontribuojnë ndryshimeve të konsiderueshme pozitive në zhvillimin e gjithmbarshëm të Kosovës.

Për t'u kualifikuar për aplikim, organizata aplikuese duhet:

- të jetë organizatë joqeveritare e regjistruar në Kosovë;
- të jetë organizatë aktive e shoqërisë civile në Kosovë;

<sup>4</sup> Për nevojat e kësaj Thirrjeje, proceset e politikëbërjes përfshijnë nismat për hartimin e Koncept-Dokumenteve, dokumenteve strategjike dhe legjisllacionit primar/projektligjeve.

Përkrahur nga:

- të ketë përvojë të dëshmuar në zbatimin e suksesshëm të nismave relevante; dhe
- të jetë organizatë udhëheqëse për zbatimin dhe menaxhimin e kësaj kontrate.

### **Numri i aplikacioneve të paraqitura për projekt**

Organizatat aplikuese mund të aplikojnë me vetëm një propozim.

### **Kohëzgjatja e projektit**

Kohëzgjatja për zbatimin e projekteve të kontraktuara është 15 muaj, përkatësisht nga 1 janari i vitit 2018 deri më 31 mars të vitit 2019.

### **Vlera e kontratës**

Shuma maksimale e fondeve për monitorimin e një procesi të politikëbërjes është 2,500 euro, ndërsa vlera maksimale për një kontratë është 20,000 euro. Organizatat aplikuese janë të obliguara që ta paraqesin ofertën financiare të tyre duke u bazuar në numrin e proceseve të politikëbërjes, sipas formularit të veçantë për këtë Thirrje.

### **Aplikimi**

Organizatat aplikuese duhet të aplikojnë me projektpropozime që janë në përputhje me këtë Thirrje dhe të përdorin formularin standard për këtë Thirrje.

Aplikimet e shkruara me dorë nuk do të pranohen.

Organizatat aplikuese duhet t'i plotësojnë formularët e aplikimit në gjuhën shqipe, serbe ose angleze.

Aplikacionet mund të dorëzohen vetëm në formë elektronike në formatin .doc ose .pdf në këtë e-mail: [hulumtimi@kcsfoundation.org](mailto:hulumtimi@kcsfoundation.org) me titullin ***“Sida SMPK – emri i plotë i organizatës aplikuese (akronimi)”***

Emaili duhet t'i përmbajë këto dokumente:

- Formularin e plotësuar të aplikimit
- Shtojcat
  - Shtojca A – Oferta financiare
  - Shtojca B – Lista fillestare e proceseve të politikëbërjes e propozuar nga organizata aplikuese për tu monitoruar
- Certifikata e regjistrimit e OJQ-së.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikacioneve është 27 nëntor 2017.

### **Vlerësimi**

Aplikacionet do të vlerësohen nga një Komision Vlerësues. Vlerësimi do të bazohet në kriteret e relevancës së proceseve të politikave, kapacitetet e organizatës dhe ofertën financiare.

KCSF-ja e rezervon të drejtën për të negociuar me organizatat aplikuese për numrin e proceseve të përzgjedhura të politikave dhe njësive qeveritare të propozuara për monitorim.

Përkrahur nga:

## **Njoftimi për vendimin**

Të gjitha organizatat aplikuese do të njoftohen për vendimin e Komisionit Vlerësues. Lista e organizatave të kontraktuara do të publikohet në [www.kcsfoundation.org](http://www.kcsfoundation.org)

## **Afati kohor tentativ**

- Shpallja e Thirrjes - 6 nëntor 2017
- Seanca e informimit – 10 nëntor 2017; ora 10:00
- Afati i fundit për dorëzimin e projektpropozimeve – 27 nëntor 2017
- Njoftimi për vendimet – dhjetor 2017
- Nënshkrimi i kontratave – dhjetor 2017
- Trajnimi fillestar për organizatat e kontraktuara - dhjetor 2017
- Dorëzimi i listës përfundimtare të dokumenteve që duhet të monitorohen - janar 2018 (10 ditë pas miratimit të Planit Vjetor të Qeverisë për vitin 2018)
- Fillimi i monitorimit - 1 shkurt 2018
- Mbyllja e monitorimit - 31 dhjetor 2018
- Raportimi i rregullt dhe periodik – për tu dakorduar me KCSF-në
- Raportet vjetore për institucionet e përzgjedhura - 15 shkurt 2019
- Mbyllja e kontratës - 31 mars 2019

## **Kontakti**

Për çdo çështje që ka të bëjë me përgatitjen e aplikacionit, organizatat aplikuese mund të shkruajnë në [hulumtimi@kcsfoundation.org](mailto:hulumtimi@kcsfoundation.org)

## **Sesioni i informimit**

Një sesion i informimit për këtë Thirrje do të organizohet më 10 nëntor 2017, në orën 10:00, në zyrën e KCSF-së, Rr. Fazli Greiçevci, Nr. 55, Prishtinë. Të gjitha organizatat e interesuara inkurajohen që të marrin pjesë. Nuk ka nevojë për regjistrim apo konfirmim paraprak.

Përkrahur nga: